



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranuar / Dostigjen / Received / Delivered	08.05.2023	3	viti / god / year
Organ / Njësia / Organ / Jedinica / Org. / Unit	Rr. / Prot. / Br. / Prot. / Prot. No.	Shtesa / Prilog / Appendix	Sasia / Kolicina / Quantity
Slavshack	4140/2023		115



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.498/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendorsjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Arben Mehmeti-anëtarë, si dhe Ilire Mehmeti-Shaqiri-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.498/2023 të datës 14.03.2023 të parashtruar nga ankuesi

kundër Formularit për Vlerësimin e Rezultateve në Punë të datës 31.01.2023 të Zëvendës Udhëheqësit Ekzekutiv të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore, në çështjen juridike "vlerësim i rezultateve në punë", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.3 dhe 1.4 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 08.05.2023, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET si e bazuar ankesa me numër A.nr.498/2023 e datës 14.03.2023 e parashtruar nga ankuesi

II. ANULOHET Vlerësimi i rezultateve në punë për vitin 2022, për ankuesin.

III. OBLIGOHET Udhëheqësi i Drejtpërdrejtë i ankuesit respektivisht Zëvendësuesi i Udhëheqësit Ekzekutiv i Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore, që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimin të këtij vendimi, duke bërë rivlerësimin e rezultateve në punë për ankuesin për periudhën nga data 01.01.2022 deri me datën 31.12.2022 në pajtim me legjislacionin në fuqi.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në Këshillin e Kosovës për Trashëgimi Kulturore, sipas Akt emërimit me AE.Nr.01/2022 të datës 03.02.2022, në vendin e punës Udhëheqës i Divizionit-

Programit për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore Materiale, më datë 14.03.2023, ka parashtruar ankesë me numër protokollit 2638/2023, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Formularit për Vlerësimin e Rezultateve në Punë të për vitin 2022 të Zëvendës Udhëheqësi Ekzekutiv i Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës komfor dispozitave ligjore në fuqi me datën 14.03.2023 ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore, ndërsa me datën 24.04.2023, Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore, me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 2638/2023 e datës 14.03.2023 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vlerësimin e dërguar me e-mail nga K.B për I.K me datë 20.02.2023; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë për ankuesin për vitin 2022; Plani Individual i Punës i periudhës 14.03.2022-31.12.2022; Vendimi me numër protokollit 6221/2921 të datës 17.12.2021 të KPMSHCK-së; E-mail i dërguar nga K.B për Z.H me datë 09.08.2022; E-mail i dërguar nga I.K për K.B me datë 16.09.2022; E-mail i dërguar nga K.B për I.K me datë 19.09.2022; E-mail i dërguar nga I.K për K.B me datë 11.11.2022; E-mail i dërguar nga K.B për I.K me datë 09.11.2022; E-mail i dërguar nga K.B për I.K me datë 19.09.2022; E-mail i dërguar nga K.B për Z.H me datë 10.01.2022; E-mail i dërguar nga I.K për A.K, B.E dhe A.H me datë 21.01.2022; E-mail i dërguar nga A.K për Z.H me datë 21.01.2022; E-mail i dërguar nga K.B për Z.H me datë 24.01.2022; E-mail i dërguar nga K.B për Z.H me datë 22.01.2022; E-mail i dërguar nga I.K për Z.H, A.B, S.K, V.G, S.B dhe KKTK me datë 22.02.2022; E-mail i dërguar nga K.B për Z.H me datë 22.01.2022; E-mail i dërguar nga I.K për Z.H, A.B, S.K, V.G, S.B dhe KKTK me datë 25.02.2022; E-mail i dërguar nga I.K për Z.H me datë 22.01.2022; E-mail i dërguar nga I.K për Z.H, A.B, S.K, V.G, S.B dhe KKTK me datë 22.02.2022; E-mail i dërguar nga I.K për Z.H me datë 22.01.2022; E-mail i dërguar nga I.K për Z.H, A.B, S.K, V.G, S.B dhe KKTK me 01.03.2022; E-mail i dërguar nga I.K për K.B, A.H, A.K dhe B.E të datës 10.05.2022; E-mail i dërguar nga K.B për I.K, A.H, A.K dhe B.E të datës 10.05.2022; E-mail i dërguar nga I.K për K.B, A.H, A.K dhe B.E të datës 06.05.2022; E-mail i dërguar nga K.B për I.K, A.H, A.K dhe B.E të datës 06.05.2022; E-mail i dërguar nga I.K për A.H, A.K dhe B.E të datës 04.05.2022; E-mail i dërguar nga K.B për I.K, A.H, A.K dhe B.E të datës 29.04.2022; E-mail i dërguar nga I.K për Z.H, S.K dhe V.G të datës 18.11.2022; Kërkesë për përgjigje në ankesë me numër protokollit 3040/2023 e datës 27.03.2023; Përgjigje në ankese me numër protokollit e datës 3737/2023 e datës 24.04.2023; Akt emërimi i ankuesit I.K me AE.Nr.01/2022 të datës 03.08.2022; Shpallje e avancimit-rekrutimit të lëshuar nga Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore; Ndryshim dhe plotësim i aktit të emërimit të ankuesit i datës 01.09.2015; E-mail i dërguar nga K.B për A.L, A.H, A.S, A.M, B.E, I.K, H.D dhe L.A të datës 08.12.2022; E-mail i dërguar nga K.B për L.A me datë 24.04.2023; E-mail i dërguar nga I.K për K.B me datë 01.01.2023; Raporti Vjetori i Punës i ankuesit I.K; Shkresa elektronike të datës 07.09.2022; E-mail i dërguar nga K.B për L.A të datës 19.04.2022; E-mail i dërguar nga K.B për I.K, A.H, A.K dhe B.E të datës 10.05.2022; E-mail i dërguar nga I.K për K.B, A.H, A.K dhe B.E të datës 06.05.2022; E-mail i dërguar nga K.B për I.K i datës 06.05.2022; E-mail i dërguar nga I.K për A.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të bashkëngjitura si nga ankuesja ashtu edhe nga organi i punësimit

ka vërtetuar se ekziston baza ligjore për të vendosur, që lënda e ankuesit
rivlerësim, sepse:

të kthehet në

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ndaj vlerësimit të rezultateve në punë për vitin 2022 pretendon se i njëjti është bërë jashtë afatit ligjor, nuk është diskutuar asnjëherë për arritjen e objektivave, dhe po ashtu me rastin e sistemimit në pozitën Udhëheqës i Divizionit ka qenë obligim që të bëhet ndryshimi i objektivave në raport me pozitën e Udhëheqësit të Departamentit.

Me qëllim të shqyrtimit të ligjshmërisë së procedurës së vlerësimit të rezultateve në punës dhe pretendimeve ankimore të ankuesi, Kolegji në kuptim të vendosjes meritore i'u referua nenit 43 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, më të cilin përcaktohet se: 1. Vlerësimi i rezultateve në punë është proces i përhershëm, që përfshin vlerësimin e realizimit të objektivave të paracaktuar dhe vlerësimin e sjelljes profesionale të nëpunësit civil në realizimin e objektivave. Periudha e vlerësimit zgjat 1 vit dhe fillon nga 1 janari dhe mbaron më 31 dhjetor. Vlerësimi bëhet deri më 31 janar të vitit të ardhshëm, për vitin pasues. 2. Vlerësimi i rezultateve në punë bazohet në objektivat e paracaktuar në mënyrë individuale për nëpunësin që vlerësohet, në përputhje me përshkrimin përkatës të punës dhe objektivat e njësisë apo institucionit. 3. Objektivat përcaktohen me shkrim, në fillim të vitit, në muajin janar, së bashku me planin e veprimtarive për arritjen e objektivave. 4. Objektivat përcaktohen nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë, në bashkëpunim me nëpunësin dhe e bëjnë me dije atë.. 6. Gjatë periudhës së vlerësimit, mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë zhvillon takime me nëpunësin që vlerësohet, për të rishikuar progresin e bërë në arritjen e objektivave të planifikuar për të shprehur mendime dhe për të dhënë sugjerime, si dhe për të bërë përmirësimet e nevojshme në planin e hartuar me shkrim. 7. Në fund të periudhës së vlerësimit, mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë harton një raport vlerësimi. 8. Raporti i jepet punonjësit dhe ai diskutohet në një intervistë me të. 9. Pas intervistës, mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë miraton raportin përfundimtar të vlerësimit....

Po ashtu Kolegji i Këshillit mori parasysh edhe dispozitat e Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publik, përkatësisht nenin 5 ku përcaktohet se : Vlerësimi i rezultateve në punë për nëpunësin përbëhet prej fazave, si në vijim: 1.1. përcaktimin e objektivave; 1.2. vlerësimin e progresit të arritur gjatë periudhës së vlerësimit, për realizimin e objektivave të paracaktuar; dhe 1.3. vlerësimi në fund të periudhës vlerësuese (vlerësimi përfundimtar). 2.Nëse gjatë periudhës së vlerësimit, ndërrohet mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i nëpunësit para përfundimit të vlerësimit vjetor, ai vlerëson nëpunësin vetëm për periudhën përkatëse, ndërsa për periudhën e mbetur të vlerësimi vjetor, vlerësimi bëhet nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejt pasues. Objektivat e punës duhet të jenë konkrete, të matshme, të arritshme, reale dhe të paracaktuara në kohë.

Në kuptim të kuadrit ligjor si me sipër, Kolegji ka analizuar shkresat e lëndës dhe si rrjedhojë ka gjetur se Zëvendësuesi i Udhëheqësit Ekzekutiv të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore, në cilësi të vlerësuesit, vlerësimin e ankuesit lidhur me rezultatet në punë për vitin 2022 e bazon vetëm në një objektiv ku ka vlerësuar që aktivitetet e ankuesit kanë qenë të vlerësuar me notën 1.2 ndërsa për dy objektivat e tjerë nuk ka vlerësuar që ka pasur aktivitete nga ankuesi.

Meqë plani individual i punës për vitin 2022 është në provat e lëndës, Kolegji i Këshillit, vlerëson se ky plan është i paracaktuar për pozitën Drejtor i Departamentit për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore Materiale, mirëpo meqë sipas Vendimit të datës 03.08.2022 të Zëvendësueses së Udhëheqëses së Burimeve Njerëzore të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore, është anuluar vendimi i datës 09.09.2021 për emërimin e ankuesit në pozitë të mesme drejtuese (Drejtor

i Departamentit për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore Materiale), dhe i cili është vërtetuar me Vendimin A.nr.753/2022 të datës 28.10.2022 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, atëherë sipas Kolegjit ankuesi nga data 03.08.2022 nuk e ka ushtruar pozitën Drejtor i Departamentit për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore Materiale, rrjedhimisht institucioni konkretisht mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i ankuesit ka qenë i obliguar të ndërmar veprimet juridike për ndryshimin e objektivave konform pozitës siç parashihet me nenin 6 të Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publik, ku në mënyrë shprehimore është paraparë se : *Brenda muajit Janar të vitit për të cilin bëhet vlerësimi i rezultateve në punë apo brenda tre (3) muajve të parë të emërimit të nëpunësit, mbikëqyrësi (vlerësuesi) së bashku me nëpunësin (i vlerësuar) përcaktojnë dhe pajtohen me objektivat dhe me planin e aktiviteteve për arritjen e objektivave të përcaktuara për vitin për të cilin vlerësohet. 2. Objektivat e punës duhet të jenë konkrete, të matshme, të arritshme, reale dhe të përcaktuara në kohë. 3. Objektivat dhe plani i aktiviteteve për arritjen e objektivave përcaktohen me shkrim sipas afateve në paragrafin 1 të këtij neni dhe vendosen në formularin e vlerësimit (Formularin 1) si dhe shërbejnë si bazë për vlerësimin vjetor të nëpunësit. Formularin 1 është shtojcë dhe pjesë përbërëse e kësaj Rregullore. 4. Përcaktimi i objektivave, bazohet në objektivat e institucionit dhe në përshkrimin përkatës të punës së nëpunësit. 5. Në rast ndryshimi të objektivave brenda vitit të vlerësimit, zhvillohet e njëjta procedurë sipas paragrafëve 1 deri 4 të këtij neni për pjesën e mbetur të vitit të vlerësimit”,* ndërsa në bazë të provave të lëndës nuk ka ndonjë dëshmi të jenë ndërmar veprimet në këtë aspekt.

Kolegji i Këshillit, në bazë të provave të lëndës konstaton se në rastin konkret organi i punësimit nuk ka dëshmuar me asnjë provë se ankuesi është kontaktuar nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë, për të diskutuar lidhur me periudhën e vlerësimit dhe me qëllim të diskutimit të përmbushjes së objektivave respektivisht për të rishikuar progresin e bërë ashtu siç parashihet me nenin 43 paragrafin 6 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe nenin 7 të Rregullores Nr. 21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike.

Nga provat e lëndës shihet që ankuesi ka dërguar tek mbikëqyrësi i drejtpërdrejt raportin e punës për vitin 2022, mirëpo që këtë e konteston mbikëqyrësi i drejtpërdrejt për faktin se thekson se raporti është dorëzuar më datë 01.01.2023, si rrjedhojë Kolegji i Këshillit, konstaton që vlerësimi i rezultateve në punë përfshin vlerësimin e realizimit të objektivave të paracaktuar dhe vlerësimin e sjelljes profesionale të nëpunësit civil në realizimin e objektivave, gjegjësisht periudha e vlerësimit duhet te behet për një 1 vit dhe fillon nga 1 janari dhe mbaron më 31 dhjetor, kurse vlerësimi bëhet deri më 31 janar të vitit të ardhshëm, çka nënkupton se ne rastin konkret mbikëqyrësi i drejtpërdrejt ka pasur mundësi ligjore dhe kohore që të bëjë vlerësimin e punëve që ankuesi ka kryer gjatë vitit 2022.

Kolegji i Këshillit, gjatë shqyrtimi të formularit të vlerësimit të rezultateve në punë për ankuesin për vitin 2022 konstaton se mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i ankuesit me rastin e vlerësimit të ankuesit me notën e përgjithshme 1.039, lidhur me objektivat nuk ka dhënë ndonjë koment ndërsa tek vlerësimi në bazë të sjelljeve profesionale, mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i ankuesit ka bërë vlerësimin për të gjitha fushat me notën dobët ndërsa përveç komentit se *si rezultat i sjellëve, qëndrimit dhe mosinteresimit të tij konsideroj se nuk ka treguar asnjë efektivitet gjatë tërë vitit 2022,* nuk ka ofruar dëshmi konkrete që mbështet pretendimet e tij, si rrjedhojë Kolegji konstaton se është vepruar në kundërshtim me nenin 4 paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, 1.2 pika 1.2.1 deri në 1.2.6 të Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve


Civil dhe nëpunësve të Shërbimeve Publike, ku përcakton se:” 1. Vlerësimi i rezultateve në punë përmban: 1.1. matjen e realizimit të objektivave të përcaktuara - objektivat janë prioritetet e punës së nëpunësit dhe përfshijnë aktivitetet që duhen realizuar deri në fund të periudhës së vlerësuar; dhe 1.2. matjen e sjelljes profesionale të nëpunësit - sjelljet profesionale janë aftësitë profesionale të nëpunësit të treguara gjatë realizimit të detyrave dhe ushtrimit të përgjegjësi në punë, që përfshinë: 1.2.1. planifikimin dhe organizimin; 1.2.2. vendimmarrjen; 1.2.3. motivimin, zhvillimin dhe trajtimin e paanshëm; 1.2.4. iniciativën dhe kreativitetin; 1.2.5. komunikimin dhe përfaqësimin; dhe 1.2.6. efektivitetin në punë”, andaj vlerësuesi/eprori aktual nuk ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike, me rastin e vlerësimit të rezultateve në punë për ankuesin.


Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, bazuar në prova dhe fakte të ofruara nga ankuesi dhe organi i punësimit pasi ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit ka vërtetuar se të njëjtat janë të bazuara, sepse ankuesi ka ofruar dëshmi se ka pasur aktivitete brenda periudhës vlerësuese dhe nuk ka pasur ndonjë masë të shqiptuar kështu që Kolegji i Këshillit, konstaton se sipas provave të lëndës si dhe konstatimeve në këtë vendim obligohet mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i ankuesit konkretisht Zëvendësuesi i Udhëheqësit Ekzekutiv të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore, që të shqyrtoj të gjitha faktet dhe në bazë të gjeturave të këtij vendimi të bëjë rivlerësimin e rezultateve të punës për vitin 2022 për periudhën 01.01.2022 deri më 31.12.2022 për ankuesin, si dhe të gjitha procedurat dhe afatet që kanë të bëjnë me procedurën e vlerësimit të rezultateve të punës t’i zhvilloj në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publik dhe Rregulloren Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike.

Andaj bazuar në këto rrethana, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës dhe provave të ofruara nga palët, duke u bazuar në kompetencën e Këshillit dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.498/2023

Ilire Mehmeti-SHAQIRI

Procesmbajtëse

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Zëvendësuesit të Udhëheqësit Ekzekutiv të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore;
- Udhëheqësit të Personelit të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.